

VENDIM
Nr.16, datë 3.6.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Hajredin Fuga,	Anëtar i	"	"
Zija Vuci,	Anëtar i	"	"
Franc Jakova,	Anëtar i	"	"
Kristofor Peçi,	Anëtar i	"	"
Kujtim Puto,	Anëtar i	"	"
Sokol Sadushi,	Anëtar i	"	"
Alfred Karamuço,	Anëtar i	"	"
Hilmi Dakli	Anëtar i	"	"

Me sekretare Arta Palushi më datë 1.5.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.21 Akti, që i përket:

KËRKUES: GRUPI PARLAMENTAR I PARTISE SOCIAL-DEMOKRATE, i PËRFAQËSUAR NGA ZOTI Haxhi Aliko.

OBJEKTI:

Interpretimi i nenit 24 pika 4 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Gjykata Kushtetuese, pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate me kërkesën datë 25.05.1998 ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese të bëjë interpretimin e pjesëshëm të pikës 4 të nenit 24 të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992, duke parashtruar: "nëse zbatimi i saj duhet të bëhet në çdo rast dhe për çdo marrëveshje ndërkombëtare në veçanti para ratifikimit të tyre nga ana e organeve përkatëse apo vetëm në ato raste kur për to lindin dyshime për papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën ose me ligjet kushtetuese".

Sipas pikës 4 të nenit 24 të ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata Kushtetuese "vendos për papajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë para ratifikimit të tyre si dhe për përputhjen e ligjeve me normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare si dhe me marrëveshjet në të cilat Republika e Shqipërisë është palë".

Gjykata konstaton se sipas pikës 5 të nenit 16 të Ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" nr.7491, datë 29.04.1991, Kuvendi Popullor ratifikon dhe denoncon traktatet me karakter politik; traktatet ose marrëveshjet me karakter ushtarak; traktatet dhe marrëveshjet që kanë të bëjnë me kufijtë e Republikës së Shqipërisë; traktatet ose marrëveshjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat themelore të shtetasve; traktatet që kanë si rrjedhim detyrime financiare për shtetin; traktatet ose marrëveshjet e tjera me të cilat parashikohet që ratifikimi ose denoncimi i tyre të bëhet nga Kuvendi Popullor.

Po ashtu sipas pikës 10 të nenit 28 të këtij ligji, Presidenti i Republikës lidh traktate ose marrëveshje ndërkombëtare; ratifikon dhe denoncon ato që nuk i shqyrton vetë Kuvendi Popullor.

Gjithashtu, sipas pikës 6 të nenit 36 të këtij ligji dhe Këshilli i Ministrave lidh marrëveshje ndërkombëtare, miraton dhe denoncon ato që nuk i nënshtrohen ratifikimit.

Nga të gjitha këto traktate e marrëveshje objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese bëhen vetëm ato që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë para ratifikimit të tyre, kusht ky që është përcaktuar shprehimisht në pikën 4 të nenit 24 të ligjit kushtetues.

Marrëveshjet e lartpërmendura mund të bëhen objekt për shqyrtim në këtë Gjykatë në kushte të caktuara, kur për shqyrtimin e pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën bëhet kërkesë e argumentuar nga subjektet që e venë në lëvizje sipas nenit 25.

Pra, për të arritur në këto përfundime duhen parë në harmoni që të dyja këto dispozita të ligjit

kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në mbështetje të nenit 24 pika 1 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime ne ligjin nr.7491, datë 29.4 1991"Për dispozitat kryesore kushtetuese"" njëzëri,

VENDOSI:

1. Gjykata Kushtetuese është kompetente të shqyrtojë pajtueshmërinë (përputhjen) me Kushtetutën vetëm për marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe gjithmonë para ratifikimit të tyre;

2. Kontrolli Kushtetues nga Gjykata Kushtetuese për këto marrëveshje, për çdo rast konkret inicohet nga subjektet e parashikuara nga neni 25 i ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", vetëm kur ato e çmojnë si të domosdoshëm një kontroll të tillë dhe kur me kërkesë të argumentuar i drejtohen kësaj Gjykate".

Ky interpretim, për këtë pjesë të pikës 4 të nenit 24 të këtij ligji, është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.